



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 117 datë 17.12. 2025

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS, PLANIT TË KONSULTIMEVE DHE
PLANIT TË BUXHETIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të pjesës së gjashtë “Qeverisja Vendore”, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar; nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma **b**; nenit 51, pika 3; nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak Përmet, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratoj planin e punës të Këshillit të bashkisë Përmet për vitin 2026, sipas tabelave bashkëlidhur.
 - a) Plani i aktiviteteve dhe plani i vendim-marrjes
 - b) Plani i konsultimeve të Këshillit të bashkisë për vitin 2026.
 - c) Plani vjetor i buxhetit për vitin 2026.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Keshillit dhe Këshilli Bashkiak në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI





Këshilli Bashkiak Përmet

PLANI I PUNES 2026

(Plani i aktiviteteve dhe Plani i vendim-marrjes 2026)

Muaji	Pershkrimi i Aktivitetit
Përmbledhëse	Mbledhje Këshilli: gjithësej 12 (nje mbledhje ne cdo muaj) *(ketu nuk jane parashikuar mbledhje jashte radhe, te cilat mund te organizohen si pasoje e kerkeses ne situata te caktuara)*
	Mbledhje Komisionit të Përhershëm e Mikse (mesatarish 2-3 mbledhje komisionesh në muaj)
	Takime me komunitetin, konsultime (4NjA): Buxhet (çdo NjA+ komuniteti biznesit+OJF), Ndryshim buxheti (1 konsultim në Bashkinë Qendër dhe 1 konsultim në zonën gjeografike që efektohet nga ndryshimi), Paketë fiskale (çdo NjA+ komuniteti biznesit+OJF), Norma e standarte e rregullore të shërbimeve dhe funksioneve të tjera ligjore (sipas grupit të interesit dhe shtrirjes se shërbimit); strategjitë (strategjia e zhvillimit 1 në çdo NjA), Planet e shërbimeve (p.sh, plani barazia gjinore, integriteti, 1 konsultim në secilën NjA + 3 me grupe interesi),
	Nisëm e këshillit bashkiak me projekt vendim për markimin e shtigjeve që kalojnë në zonat ku ka stane për të promovuar dhe standartizuar turizmin malor sipas manualit kombëtar dhe vecanërisht traditën e staneve dhe shtigjeve si pjesë e turizmit rajonal. Kështu synojmë të zhvillojmë ekonomine familjare të barinjve dhe fusim bashkinë e Përmet në hartën rajonale të shtigjeve për të targetuar turistë të shumtë që kanë pikërisht këtë interes.
	Vizite studimore (1 vizite për shkëmbim eksperience jashtë vendit, 1 vizitë brenda vendit) zone rurale turizem malor
	Aktivitet sensibilizues dhe ndërgjëgjësues (1), në kuadër të "Tetorit Roze"
	Nxitje e mbështetje e iniciativave të komunitetit: Për përmiresimin e mjedisitit
	Ceremoni dhënie titull nderi (6)
	Pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete të ngjashme (10 ne vit)
	Pritje e delegacionit nga këshilla homologe



	▪ Përfaqesim institucional i Këshillit në ngjarje, psh festa vendore, ngjarje ku ftohet Këshilli
	▪ Pjesëmarrje në Organet Drejtuese të Agjencive ku Këshilli është anëtar apo përfaqësohet
	▪ Monitorim, auditim i njësive shpenzuese të varesisë së Bashkisë, strukturave komunitare.
	▪ Hartim i dokumenteve planifikues e rregullator te KB: buxheti vjetor, plani vjetor i vendim-marrjes, plani i komunikimit me publikun, rregulla te funksionimit të KB
Janar	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të : 1. Finances dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Anketimi vjetor për vleresimin nga komuniteti të punës të Këshillit, pyetsor ▪ Raport mbi zbatimin e vendimarrjes se këshillit bashkiak për 6-mujorin e dytë të 2025.
Shkurt	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të: 1. Financës dhe Buxhetit; 2 _____; 3 _____; 4 _____;
	▪ Raporti i Performances së punës së Këshillit për vitin 2025 – pergatitja ne forme elektronike e buletinin të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak per 2025.
Mars	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të: 1. Financës dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete te ngjashme
	▪ Drejtoria e Zhvillimit ekonomik: "Miratimi i raportit vjetor te zbatimit te buxhetit për vitin 2025"
Prill	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të: 1. Financës dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Ceremoni per dhenie tituj nderi
	▪ Vizitë studimore/shkëmbim experience brenda vendit
	▪ Raportim nga Specialist i integritit ne BE dhe ndihmës së huaj dhe turizmit "Mbi masat e marra në sektorin e mjedisit dhe turizmit per fillimin e sezonit turistik 2026". ▪ Dëgjese ose konsultim pblik me komunitetin për çështje të mundshme që vijnë nga ekzekutivi ose qytetaret si psh: ndryshime buxheti, ndryshine ne paketen fiskale, dhenie me qira, miratimin e normave e standarteve te reja te sherbimeve publike, plane strategjike, etj.
Maj	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të: 1. Financës dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;



	▪ Perditësim i regjistrit të kërkesave për informim për dokumentacionin e keshillit (ligji nr. 119/2014)
	▪ Raportim nga Drejtoria Zhvillimit Rural; Mbi kontrollin dhe zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratën e qerasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” dhe për dhënie në përdorim të tokës bujqësore të pandarë, për kontratat e lidhura me afate të gjatë dhe raportimi mbi gjendjen e lerae. Konsultime me publikun (4 takime) në lidhje me prioritetet për PBA 2026-2028. (1 në Njesinë administrative Përmet, + 1 në Nj.A Çarshovë+ 1 Nj.Ad Petran + 1 Nj.Ad. Piskovë - Frashër)
	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisionëve të Përhershëm të: 1. Finances dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Miratimi i Draftit të Pare të PBA ▪ Miratimi i ndihmave ekonomike, 6% ▪ Informacion nga MZSH: "Mbi masat paraprake për parandalimin e zjarrit dhe përballimin e emergjencave civile gjatë sezonit turistik".
Qershor	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisionëve të Përhershëm të: 1. Finances dhe Buxhetit; 2. Mandateve: 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Miratimi i Draftit të Pare të PBA
	▪ Miratimi i ndihmave ekonomike, 6%
Korrik	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisionëve të Përhershëm të: 1. Finances dhe Buxhetit; 2. Mandateve: 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Raportim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike: Mbi masat e marra për ruajtjen dhe zgjerimin e ambjentëve të gjelbruara në qytet si dhe grumbullimin dhe perpunimin e mbetjeve urbane në perputhje me standartet e lejuara, masat që janë marrë për sistemin e mirëmbajtjes së varrezave të deshmorëve dhe atyre publike në Bashkinë Përmet.
	▪ Pritje e delegacionit nga keshilla homologe (kthim vizite e aktivitetit të muajit prill) ▪ Degjese ose konsultim publik me komunitetin për çështje të mundshme që vijnë nga ekzekutivi ose qytetaret si psh: ndryshime buxheti, ndryshime në paketën fiskale, dhenie me qira, miratimin e normave të standarteve të reja të shërbimeve publike, plane strategjike, etj. ▪ Raport mbi zbatimin e vendimarrjes së keshillit bashkiak për 6-mujorin e parë.
Gusht	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisionëve të Përhershëm të: 1. Finances dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Informacion nga Drejtoria e Arsim Kulturës / Kujdesit Social, Drejtoria e shërbimeve publike: Mbi masat e marra nga për përgatitjen e ambienteve shkollorë për fillimin e vitit të ri shkollor 2026-2027, arsimit parashkollor, konviktit, cerdhe, kopshte si dhe qendrat sportive në bashkinë Përmet.
Shtator	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisionëve të Përhershëm të: 1. Financës dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;



	▪ Analizë nga Sektori i Emergjencave Civile pranë Bashkisë: Raportim mbi përballimin e emergjencave gjatë vitit 2026 si dhe masat e marra për vitin 2027.
	▪ Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar: Raport mbi zbatimin e buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet) peë 8 mujorin 2026. ▪ Vizitë studimore/shkëmbim experience jashte vendit. ▪ Raportim nga Policia Bashkiake dhe IKMT mbi gjendjen e sigurise publike dhe kontrollin e territorit ne Bashkisë Përmet.
Tetor	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të: 1. Financës dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Aktivitet ndërgjegjësues dhe sensibilizues për "Tetorin Roze" me grate ne komunitet (me teme mbi kancerin e gjirit dhe barazine gjinore), ne bashkepunim me Bashki te Forta
	▪ Konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit për ndryshime të PBA 2026-2028 dhe buxhetin 2026 (4 takime) 1 ne qytet +3 ne NJ.A nga 1 per secilen.
	▪ Hartimi i Planit të Punës dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2027
	▪ Raportim për problematikat dhe veprimtarinë në Njësitë Administrative (Çarshovë, Petran, Piskovë - Frashër) të Bashkisë Përmet. ▪ Raportim nga zyra e Tatimit – Taksave mbi veprimtaritë e bizneseve të lidhura me turizmin në Bashkinë Përmet. (Statistikat mbi nr. e aktiviteteve si dhe ndryshimet në shtimin dhe pakësimin e tyre si dhe informacion mbi shlyerjen e detyrimeve të bizneseve). ▪ Degjese ose konsultim publik me komunitetin për çështje të mundshme që vijnë nga ekzekutivi ose qytetarët si psh: ndryshime buxheti, ndryshime në paketën fiskale, dhenie me qira, miratimin e normave të standarteve të reja të shërbimeve publike, plane strategjike, etj.
Nëntor	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të: 1. Financës dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;
	▪ Konsultim publik me komunitetin dhe grupet e interesit për ndryshime në paketën fiskale (5 takime) (1 në Njësinë administrative Përmet, +3 në Nj.A Çarshovër + Nj.Ad Petran + Nj.Ad. Piskovë - Frashër, + 1 publike OJF, etj.
	▪ Raportim nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit: Për zbatimin e Planit të Përgjithshëm vendor, investimet e parashikuara dhe problematikat.
	▪ Pjesëmarrje në konferencë dhe aktivitete të ngjashme ▪ Prezantimi i raportit të performancës për Bashkinë Përmet për vitin 2026.
Dhjetor	▪ Mbledhje e Këshillit
	▪ Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm të: 1. Financës dhe Buxhetit; 2. Mandateve : 3. Barazia gjinore: 4. Arsim -Kultura;

BUKAR

- | | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none">▪ Diskutimi, konsultimi dhe miratimi i Buxhetit vjetor dhe paketes fiskale për vitin 2027. |
| | |

- | | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none">▪ Për Kryesinë e Këshillit Bashkiak: Anila Dhimitri▪ Sekretar i Këshillit Bashkiak: Aleks Tane |
|--|---|

